

**BEQIR META****DISA TË DHËNA HISTORIOGRAFIKE PËR ORIGINËN,  
POPULLSINË DHE VENDBANIMET E VLEHËVE**

Një nga çështjet më të diskutueshme dhe mjaft e komplikuar është ajo e numrit dhe e shtrirjes së vendbanimeve të vllhëve në Ballkan e po kështu edhe në Shqipëri. Lidhur me numrin dhe shtrirjen gjeografike të arumunëve ka të dhëna të ndryshme dhe nganjëherë diametralisht të kundërta.

Sipas Alexic-it, arumunët e Maqedonisë, Shqipërisë dhe Epirit nuk e kapnin shifrën e 300 mijë vetëve.

Shifra interesante të cilat mund të konsiderohen bindëse dhe jo tendencioze ka dhënë Gustav Weigand, i cili i shëtit vendbanimet e vllhëve në Shqipëri, në vitin 1889<sup>1</sup>. Ai i ndante arumunët në këto grupe:<sup>2</sup>

**I - Arumunët shqiptarë në malësinë e Gramozit**

- Densku (në malësinë Jugperëndimore), 400 vetë
- Pilgadhës (në Jug të Malësisë), 250 vetë
- Gramozi (Lindje e Malësisë), fshatrat Nikolicë, Linotrop, Fusha, Varten, 300 vetë.

**II - Grupi i malësisë së Moravës**

- Plasa, 540 banorë vllhë
- Stropan 240 “ “
- Morava 180 “ “

**III - Grupi i malësisë së Kamnes**

- Llënga, 450 banorë vllhë
- Niça 150 “ “
- Grabova 400 “ “

---

<sup>1</sup> Gustav Weigand, *Die Aromunen - Ethnographisch - Philologisch - Historische Untersuchungen*, Leipzig: 1895.

<sup>2</sup> *Po aty*, f. 286.

**IV. Grupi Dörfer në Musakje (fshatrat në Myzeqe),** zona nga perëndimi i Beratit deri në Detin Adriatik. Këtu gjashtë fshatra kishin shumicën e popullsisë vllehe. Weigandi pohonte se, kishte gjithashtu edhe disa shtëpi të shpërndara, të cilat së bashku me shtëpitë në 38 fshatra të Myzeqesë, arrinin në 1000 shtëpi, me 7000 banorë. Numri i tyre në dimër, si rezultat i shtegtimimit të bagëtive, së bashku me familjet vllehe mund të arrinin deri në 10.000 banorë. Weigandi jepte për Shqipërinë numrin e përgjithshëm 16.850 vllleh.

Një shifër të moderuar dhe të përafërt me rezultatet e Weigandit, jepte disa dekada më vonë edhe Instituti Kombëtar i Statistikave dhe i Studimeve Ekonomike të Francës. Sipas një botimi të tij, arumunët ose kucovllëhët e Shqipërisë llogariteshin nga 10.000-20.000 persona. Ata kishin emigruar nga Rumania ose mund të ishin edhe mbeturina të kolonive romane ose pasardhës të popullsisë iliro-latine, megjithëse rumunët i cilësonin si thrako-latinas.<sup>3</sup>

Për ta bërë më të plotë tablonë mund të sjellim edhe të dhëna të tjera për zona të veçanta të Shqipërisë. Kështu konsulli gjerman në Selanik, mendonte se, Frashëri kishte 120 banorë vlllehë, Zarkani 50, Mitsani 30, Zavalani 75. Voskopoja kishte 120 familje arumune dhe 100 familje shqiptare, të cilat kishin së bashku 720 banorë, Korça 600 arumunë, Bilishti 120, Elbasani 500.

Hahn-i jepte për Tiranën 100 shtëpi me 1000 banorë, për Kavajën 10 shtëpi me 80 banorë, Durrësi 50 banorë, Vlora 60 banorë, Berati 3000 banorë.<sup>4</sup> Haret llogariste se në të dy vilajetet e Selanikut e Manastirit banonin 124 000 kucovllëhë.<sup>5</sup> Ndërsa Pouqueville mendonte se kjo shifër ishte vetëm 47.000.<sup>6</sup>

Mjaft të ekuilibruara dhe ndoshta më të besueshmet mund të konsiderohen burimet zyrtare turke. Statistikat turke të vitit 1908 për kazanë e Korçës japin këto shifra: 33894 rumë (ortodoksë) që flasin shqip, 34171 myslimanë (shqiptarë) 1544 ortodoksë vllahofonë.<sup>7</sup>

<sup>3</sup> *Les Minorités Ethniques En Europe Centrale Et Balkanique*, Institut National De La Statistique Et Des Études Economiques, Paris: "Presses universitaires de France", 1946, f.14.

<sup>4</sup> *Po aty*.

<sup>5</sup> Giovanni Amadori, Virgilj, *La Questione Rumeliota (Macedonia, Vecchia Serbia, Albania, Epiro) e la Politica Italiana*, Roma: 1908, f. 317.

<sup>6</sup> *Po aty*, f. 311.

<sup>7</sup> Demetre Kolovani, *La Question de Koritza*, Paris: 1916, f.19.

Ndërsa burimet historike dhe diplomatike greke japin shifra shumë të vogla për popullsinë vllahe të cilat janë sigurisht tendencioze. Sipas Christovassilisit kucovllehët popullonin jo më shumë se 10 fshatra të Epirit. Ai thekson se “kucovllehët shqiptarë të Epirit, që numërohen në rreth 700 familje nomade të shpërndara në Prevezë, Pargë, Paramithi, Filat, Delvinë, Vlorë, Musakia dhe në lokalitetin e Zagorisë, flasin mirë në mënyrë të barabartë tre gjuhë: greqisht, vllahisht dhe shqip, por shkruajnë vetëm greqisht. Këta nomadë kanë ngjashmëri me grekët edhe më shumë se kucovllehët e tjerë epirotë”<sup>8</sup>. Ndërsa thujse të gjithë shkrimtarët e politikanët grekë kanë qenë të prirur ta minimizojnë ekzistencën e vllahve, ndryshe ka vepruar ministri i Jashtëm i Greqisë, Rangabe, i cili shkruante në vitin 1854, në revistën “Pandora” të Athinës, se arumunët e Maqedonisë, Epirit e Thesalisë janë koloni të ardhura nga Rumania por që kanë karakter latin dhe numri i tyre arrin në rreth 600 mijë<sup>9</sup>.

Ashtu si dhe për shqiptarët, burimet greke e mohojnë identitetin e veçantë të vllahve. Cristovassilis thekson se, vllahët e Epirit, “jo vetëm që kanë aspirata greke dhe flasin greqishten si gjuhë amtare, por gjithashtu nuk dallojnë fare në asgjë tjetër nga grekët për ndjenjat nacionale e fetare, për dëshirat dhe idetë politike si dhe për përdorimin e kostumeve”.<sup>10</sup> Sipas tij, kjo ishte arsyeja që “propagandisti i famshëm kundër grekëve, Apostol Margariti, megjithëse pati në dorë miliona e miliona franga rumune për krijimin e një kombësie rumune, megjithëse pati edhe ndihmesën e autoriteteve turke, nuk mundi të kthente në instrument të tij asnjë kucovlleh epirot të vetëm”.<sup>11</sup>

Statistikat greke japin një numër krejt të ndryshëm të popullsisë, nxënësve dhe familjeve arumune.<sup>12</sup> Këtë pasqyrë po e japim më poshtë:

	Nxënës	Familje	Individë
Bellkamen	4	4	20
Korçë	100	70	350

<sup>8</sup> Christo Christovassilis, *La Forza dell'Ellenismo in Epiro e i Suoi Diritti*, Napoli: 1903, f. 8-9.

<sup>9</sup> Benedetto De Luca, *Gli Albanesi, Macedo-Romeni e gli Interessi D'Italia nei Balcani*, Roma: 1913, f. 39.

<sup>10</sup> C. Christovassilis, *La Forza dell'Ellenismo ...*, f.8.

<sup>11</sup> *Po aty*.

<sup>12</sup> G. Amadori, *Virgilj, La Questione Rumeliota...*, f. 315.

Elbasan	5	5	25
Moscopolis	327	20	100
Plasa	60	30	150
Shipska	8	30	150
<b>Gjithsej</b>	<b>1485</b>	<b>947</b>	<b>4735</b>

Në të dy vilajetet e Selanikut e të Manastirit statistikat greke japin 12000 vllhë ndërsa qeveria turke jepte shifrën 20 000.<sup>13</sup>

Të dhëna shumë të zvogëluara për vllhtë jepte edhe Eksarkati Bullgar i cili kishte përgatitur një statistikë të popullsisë për sanxhakun e Korçës, sipas të dhënave që kishin mbledhur agjentët e tij në vitin 1901<sup>14</sup>. Sipas këtyre statistikave rezultonte se qyteti i Korçës kishte 2077 banorë (1420 shqiptarë ortodoksë, 505 shqiptarë myslimanë, 102 arumunë). Në fshatrat e Kazasë së Korçës jepej një popullsi prej 10426 banorë (1992 banorë në fshatrat shqiptare ortodokse, 5123 banorë në fshatrat shqiptare ortodokse dhe myslimane, 1525 banorë të fshatrave të banuara nga bullgarë, 280 banorë në fshatrat e banuara nga vllhtë.)

Në një kahje të kundërt të çojnë burimet rumune e italiane të cilat japin të dhëna shumë të zmadhuara. Kështu autori italian Amadori-Virgilj, ndonëse pohon se në qytetet Leskovik, Gjirokastër, Delvinë, Berat, Skrapar, Vlorë, Lionsnia nuk kishte nxënës dhe shkolla arumune (përmend vetëm një shkollë në Përmet me 18 nxënës dhe një mësues)<sup>15</sup>, flet për një numër relativisht të madh të popullsisë vllahe në Shqipërinë e Mesme. Konkretisht:

	<b>Gjithsej banorë</b>	<b>Vllhë</b>
Durrësi (qyteti e rrethi)	54 190	1 330
Tirana	32 670	1 268
Shijaku (Shijak, Ishëm, Prezë)	16 031	537
Kavaja (qyteti e rrethi)	19 316	1 609
Kruja	17 584	Asnjë
<b>Totale</b>	<b>139 791</b>	<b>4 744</b>

<sup>13</sup> *Po aty.*

<sup>14</sup> D. Kolovani, *La Question de Koritza...*, f. 40.

<sup>15</sup> G. Amadori, *Virgilj, La Questione Rumeliota...*, f. 297.

Të dhëna më të zmadhuara për prezencën e vllahve në Shqipëri jep edhe autori tjetër italian Enrico Aci Monfosca<sup>16</sup>. Ai jep këtë tablo të minoriteteve në Shqipëri për të cilën pohonte se kishte 800.000 banorë.

	<b>Banorë</b>	<b>%</b>
Iliro-rumunë	30 000	3,75
Grekë	15 000	1,87
Malazezë	1 900	0,16
Bullgaro-maqedonë	3 000	0,38
<b>Gjithsej</b>	<b>49 900</b>	<b>6,16</b>

Në këto të dhëna bie në sy tendenca për të zmadhuar vetëm numrin e vllahve, gjë që ishte një prirje e përgjithshme e diplomacisë dhe e historiografisë italiane veçanërisht gjatë periudhës së fashizmit.

Minoritetin “iliro-rumun” Monfosca e ndante në dy grupe: Frashëryjtët të cilët ndofta e kishin origjinën nga Frashëri; dhe fisi i Moskopolit (që e kishte marrë emrin nga Voskopoja, i cili ishte grupi më i asimiluar prej grekëve dhe shqiptarëve.<sup>17</sup> Ai theksonte se fenomeni i asimilimit nga shqiptarët dhe grekët kishte qenë veçanërisht i shpejtë në këto 20 vitet e fundit dhe lidhej me rizgjimimin e kombit shqiptar dhe me aksionin konkurrues grek në Shqipërinë Qendrore dhe Jugore<sup>18</sup>.

Sipas Monfosca-s, në dekadën e parë të shek. XX, popullsia rumune kishte qenë e konsiderueshme në Durrës, Tiranë, Elbasan e Berat. “Në Shqipërinë Qendrore - shkruante ai - mund të thuhet se, pothuajse në tërësi popullsia ortodokse ishte arumune ndërsa tani ajo konsiderohet ose si shqiptare ose si greke”. Ai pretendonte se në qendrën e Durrësit kishte ende 2342 banorë, në Kavajë 2144, në Tiranë 721 që ishin ortodoksë të cilët pothuajse totalisht kishin origjinë arumune. Ndërsa sipas tij në provincën e Elbasanit popullsia arumune ishte 2221 banorë, në Malin e Sopotit 3414 banorë, ndërsa bërthama të tjera të vogla kishte dhe në fshatra. Ai theksonte se popullsia arumune e Durrësit, Tiranës e Elbasanit përbënte rreth 18 % të popullsisë totale të këtyre provincave. Ai pohonte

<sup>16</sup> Enrico Aci Monfosca, *Le Minoranze Nazionali Contemplate Dagli Atti Internazionali*, volume II, Paesi Danubiani, Balcanici e Turchia, Firenze: “Vallecchi”, 1929, f.191.

<sup>17</sup> *Po aty*, f.195.

<sup>18</sup> *Po aty*.

se në jug të Durrësit, në Musacchia, takohen grupet më të forta të frashëriotëve nomadë dhe se të tjera fise arumune më të stabilizuara në Shqipërinë e Jugut gjendeshin në rajonin e Korçës. Në qytetin e Korçës kishte sipas tij 3000 arumunë.

Sipas De Luca-s qendrat më të rëndësishme të vllëve ishin: Manastiri, Crusciova, Hrupiste, Gopesci, Moloviste, Negovan, Ohri, Paticina, Papadia, Perlepe, Vlaho-Clisura, Magarova, Resna, Nevesca, Belkamen, Iancovetzi. Në rajonin Korçë-Elbasan ishin Plasa, Korça, Voskopoja, Shipska, Elbasani, Ferivole, Turia, Abela, Grebenea, Samarina, Vlahoiani, Pretori, Janina, Berati, Briasa, Frashëri, Furka. Në zonën e Selanikut ishin Livezi, Zerna-Reca, Liumnitzza, Huma, Lugunza, Petrici, Osciani, Obar, Poroi, Giurmaia, Cupa, Ghevreheli, Birislav, Liposci.

Në rajonin e Verrisë: Verria, Sellia, Fetiza-Gramaticova, Verria-Maruscia, Verria-Xerolivad, Dolliani, Vodena.

Në rajonin Shkup - Kosovë ishin: Tetova, Lipopeltzi-Kitea, Coceani, Veles.

Ai nënvizonte se një bërthamë të fortë vllëve kishte në Pind, por që ishte denatyrizuar tërësisht dhe ishte greqizuar. Popullsia arumune cilësohej si superiore ndaj asaj greke edhe në Sanxhakun e Selfixhes, që ishte i pushtuar nga grekët<sup>19</sup>.

De Luca, pretendonte se, në Shqipërinë e Jugut rajonet e Beratit, Gjirokastrës, Elbasanit, Korçës, dhe i gjithë rajoni të cilin serbët deri atëherë e kishin quajtur “Stari Vlah” është i populluar në një shumicë të madhe nga shqiptarë e vllahë<sup>20</sup>.

Studiuesi rumun Bolintineanu jepte një shifër gati fantastike të vllëve në Ballkan (rreth 1 200 000).<sup>21</sup>

Edhe qeveria rumune ka publikuar statistika të ekzagjeruara për vllëhtë. Në vilajetin e Manastirit, sipas këtyre statistikave, kishte 101 326 banorë dhe 1707 nxënës që mësonin në shkollat arumune.<sup>22</sup> Për qendrat shqiptare jepeshin këto të dhëna:

<sup>19</sup> B. De Luca, *Gli Albanesi...*, f. 39.

<sup>20</sup> *Po aty*.

<sup>21</sup> G. Amadori, *Virgilj, La Questione Rumeliota...*, f. 311.

<sup>22</sup> *Po aty*, f. 315.

	<b>Banorë</b>	<b>Nxënës</b>
Bellkameni	3700	40
Korça	?	45
Elbasani	7500	10
Voskopojë	3260	55
Plasa	1380	65
Shipska	360	16

I njëjti raport fliste për 688 nxënës të shkollave rumune në Epir dhe 355 në Shqipëri.

Një studim interesant për vllehtë kanë botuar në vitin 1914, Alan J.B. Wace dhe M.S. Thompson<sup>23</sup>. Ata pohojnë se vllehtë e Shqipërisë njiheshin me emrin Frasherots, ndërsa grekët i quanin ata arvanito-vlakhi d.m.th. vllaho-shqiptarë. Këta autorë theksojnë se vllehtë që banojnë në Bellkamen dhe Negovan, së bashku me shqiptarët i përkisnin grupit Frashëriot.<sup>24</sup> Ata përmendin fshatrat Nikolicë dhe Linotop si fshatra që në shekullin XVIII, para se të binin në duart e shqiptarëve, kishin qenë të lulëzuara dhe me famë. Popullsia e tyre tashmë ishte larguar për në vende të tjera<sup>25</sup>.

Në veri të Gramozit ata dallonin një grup tjetër të vllëve që e kishin qendrën në qytetin shqiptar të Korçës. Ky grup ndahej në dy pjesë. Njëra shtrihej në Lindje të Korçës dhe përmblihte fshatrat Plasë, Moravë dhe Stropan të banuara kryesisht nga frashëriotë, të cilët ishin blegtorë dhe pjesa tjetër disa familje, që ishin vendosur në qytezën e përzier bullgaro-shqiptare të Bilishtit. Këto frashëriotë, ata i konsideronin si të ardhur vonë, në shek. XVIII.

Vllehtë e Korçës, sipas tyre, ishin me origjinë nga frashëriotët e Plasës dhe fshatrave afër saj, por kishte edhe disa familje nga Voskopoja, të cilat ishin më së shumti nën influencën greke, si dhe pak familje nga rajoni i Gramozit.

Nëndega tjetër e vllëve të këtij rajoni shtrihej përreth Voskopojës dhe Shipskës, të cilat në shek. XVII-XVIII, kishin qenë qytete të mëdha dhe të lulëzuara. Nga të dy Voskopojet, njëra Fusha e Muskut (Plain of

<sup>23</sup> Alan John Bayard Wace, M. S. Thompson, *The Nomads of the Balkans*, New York: 1914. Ribotim në vitin 1971.

<sup>24</sup> *Po aty*, f. 213.

<sup>25</sup> *Po aty*, f. 213-214.

Musk), ishte më e madhja dhe më e famshme, pasi ajo ishte një qendër e madhe tregtare për Shqipërinë Qendrore dhe Maqedoninë e Sipërme. Tregtarët e saj kishin degë në Venecie, Vjenë e Budapest dhe frekuentonin panairin e madh të Leipçigut. Kolonia ortodokse e pasur e Vjenës ishte, në një masë të madhe, e përbërë nga vllëhtë e Voskopojës e të vendeve të tjera.<sup>26</sup>

Vendasit besonin se qyteti i Voskopojës dikur kishte pasur 8-10 mijë shtëpi dhe një popullsi prej 60.000 frymësh. Weigandi prirej ta besonte këtë, por Leake ishte më shumë skeptik, Wace mendonte se popullsia e këtij qyteti mund të kishte qenë 20.000 vetë.

Duke gjykuar nga manastiri i Shën Prodromit, që ndodhet gjysëm ore në veri, i cili është ndërtuar në vitin 1632 dhe nga shumica e kishave në qytet, që datojnë midis viteve 1700 dhe 1760, ata arrinin në përfundimin se periudha e lulëzimit të këtij qyteti ishte midis viteve 1650 -1750.

Wace e Thompson u besonin gojëdhënave për rrënimin e Voskopojës nga shqiptarët, fillimisht në vitin 1769 dhe pastaj në vitin 1788. Në të vërtetë, sulmi mbi këtë qytet u nxit dhe u organizua nga Porta e Lartë dhe nga Patrikana greke e Stambollit, të cilat përdorën popullsinë vendase shqiptare duke nxitur fanatizmin fetar. Ndërsa prof. Pëllumb Xhufi, ka argumentuar bindshëm se, rënia e Voskopojës, lidhet kryesisht me arsye ekonomike dhe pikërisht me rënien e tregtisë së leshit dhe prodhimeve të tjera<sup>27</sup>. Autorët e lartpërmendur theksojnë se, më në fund, mbretërimi i ashpër i Ali Pashës solli shkatërrimin e saj të plotë dhe banorët e saj u shpërndanë nëpër Ballkan.<sup>28</sup> Megjithatë duhet nënvizuar se edhe Wace e Thompson e kanë pranuar qartësisht ngritjen dhe rënien e Voskopojës për arsye ekonomike duke dhënë edhe disa argumente për avancimin e procesit historik të asimilimit të vllëve. Ata pohojnë se, në shek. XVIII u rrit shumë tregtia që bëhej prej vllëve. Tregtarët vllëh ishin të vendosur në Janinë, Mecovë, Kalarites ndërsa Voskopoja ishte në kohën e lulëzimit të saj më të madh. Në përfundim të kësaj periudhe erdhi dhe formimi i një pjese të madhe të kolonive vllëhe përreth Manastirit dhe Seres. Tregtia e shek.XVIII prodhoi një zhvillim të madh të jetesës në vendbanime të qëndrueshme. Ajo gjithashtu pati dhe efekte të tjera, rriti peshën ekonomike të vllëve por në të njëjtën kohë ndihmoi në

<sup>26</sup> *Po aty*, f. 214.

<sup>27</sup> Pëllumb Xhufi, *Shekulli i Voskopojës (1669-1769)*, Tiranë: "Toena", 2010.

<sup>28</sup> *Po aty*, f. 215-216.

asimilimin e tyre. Vllehtë, duke u bërë tregtarë e zanatçinj në qytete, ranë në kontakt të ngushtë me racat e tjera. Mësimi i greqishtes u bë i domosdoshëm dhe jo më një çështje luksi, veçanërisht për ata që shinin në qytetet greke. Helenizmi gjithashtu u ndihmua nga pushteti i Patriarkatit i cili ishte në kulmin e tij në gjysmën e dytë të shekullit XVIII. Në vitin 1767, Patriakati grek, me ndihmën e turqve, kishte arritur të shtypte me sukses kishat bullgare, serbe dhe rumune. Kjo gjithashtu ishte koha e daljes së librave të këndimit në gjuhën greke për të mësuar shqiptarët, vllehtë e të tjerët.

Vitet e fundit të shek. XVIII ishin një periudhë furtune dhe stresi. Tregtia ra përgjithësisht; veçanërisht në Jug, në qendrat e pasura vllehe si Mecova, Vllaho-Livadhia dhe Klisura, të gjitha u përgjysmuan. Familjet që i lanë këto fshatra, të cilat kishin qenë qendra tregtare vllehe në kodra, u vendosën në qytete në fusha dhe filluan të shkrihen me racat e tjera. Kështu, rënia ashtu si dhe rritja e tregtisë, ndihmoi për zhdukjen e racës vllehe. Ndërsa helenizmi në Ballkan, i cili po shtrihej në rritje në të gjitha racat e tjera, veçanërisht midis vllëve, bëri një progres më të madh.<sup>29</sup>

Edhe “Gjeografia” e murgjve thesalianë, Daniel dhe Gregori, e botuar në Vjenë në vitin 1791, theksonte se Voskopoja ishte shumë e pasur, ajo kishte 12 lloje tregtie, një shkollë të mirë dhe të famshme, një shtypshkronjë. Pra, kishte të gjitha gjërat e çmuara të një qyteti evropian. Shtypshkronja, që drejtohej nga një murg, i cili quhej Gregori, ishte njëra nga shtypshkronjat e para në Turqinë Evropiane.

Wace e Thompson kanë shkruar se në Shqipëri kishte dy grupe të përcaktuara vllësh, grupi jugor në perëndim të malit Gramoz e deri në veri të Përmetit midis lumenjve Aous (Vjosa) dhe Osum dhe grupi verior që fillon në perëndim të Beratit. Grupi jugor përmbante vetëm 4-5 fshatra të vogla, duke përfshirë dhe Frashërin, nga i cili kishin marrë emrin frashëriotët. Përtej Beratit kishte 38 fshatra ose lagje fshatrash të gjitha të vogla me një popullsi totale në dimër rreth 1000, ndërsa në verë kjo popullsi zvogëlohej së tepërmi. Në qytetet Vlorë, Elbasan e Durrës kishte gjithashtu një popullsi vllahe. Kushtet e jetesës në Shqipëri ishin më primitive se kudo gjetkë, fshatrat ishin më të vegjël dhe më të shpërndarë, ndërsa popullsia nomade ishte më e madhe.<sup>30</sup>

<sup>29</sup> *Po aty*, f.224-225.

<sup>30</sup> *Po aty*, f.222-223.

Autorët e lartpërmendur pohojnë se fshatrat ekskluzivisht vllehe ishin të vendosura të gjitha në, ose pranë kodrave dhe vllehtë që ishin vendosur gjatë ishin kolonistë që po e humbitnin me shpejtësi kombësinë e tyre. Sipas tyre vllehtë e vendosur në kodra kishin një origjinë të hershme. Ata kishin pësuar ndryshime të njëpasnjëshme në histori si rezultat i jetës nomade.

### **Origjina dhe historia e vjetër e vllëve - një rebus i pazgjidhur**

Një problem edhe më i komplikuar është ai i origjinës, formimit dhe shtrirjes së pakicës etnokulturore arumune. Në lidhje me origjinën e vllëve ka pikëpamje të ndryshme. Studiuesit e kësaj çështje mund të ndahen në disa grupe.

Grupi i parë i historianëve kanë argumentuar pikëpamjen se arumunët janë pasardhës të një popullsie vendase, e cila është latinizuar, ose pasardhës të kolonëve romakë të vendosur në Ballkan pas pushtimit nga Roma.

Procesi i latinizimit ka ndodhur në harkun e shek. III p.e.s. deri në shek. IV të e.s., e sidomos në shek. I të e.s., kur Perandori August solli kolonë të rinj dhe kur ushtritë romake u vendosën në Ballkanin Qendror, të cilin e përdorën si bazë për të pushtuar Ballkanin Verior.

Një grup tjetër studiuesish pohojnë se arumunët janë paraardhës të rumunëve ose romakët e Ilirisë me trung të përbashkët trako-ilir të cilët janë shtrirë prej Karpateve në veri deri në Jug të Ballkanit. Kjo pikëpamje mbështetet më së shumti nga studiues rumunë.

Studiuesit grekë janë përpjekur të vërtetojnë se arumunët janë grekë të latinizuar. Ndërsa një grup tjetër studiuesish mbrojnë tezën e ardhjes së arumunëve nga veriu, nga rajoni i Danubit dhe i Savës.

Duket se pikëpamja më e bazuar është ajo që pranon latinizimin e popullsisë vendëse në rajonin e Ballkanit, e cila mbështetet kryesisht nga studiuesit perëndimorë.

Studiuesit të cilët pranojnë prezencën e vllëve në shekullin II p.e.s. argumentojnë heshtjen apo mospërmendjen e emrit vllah deri në shek. X, jo me mosekzistencën e kësaj popullsie, por me thirrjen e saj me një emër tjetër, ndoshta “romanai”. Ndërsa me daljen e emrit “vllah” shprehet formimi dhe konsolidimi i kësaj etnie, megjithëse në rajonin e Ballkanit ajo është ndeshur edhe me emra të tjerë.

Gjuha e tyre është një latinishte ballkanike që përbën një variant të latinishtes së vjetër. Ajo ka afërsi me rumanishten e sotme dhe disa studiues e quajnë si degëzim të rumanishtes së lashtë.

Emri vllah është përmendur për herë të parë në vitin 976. Katër vjet më vonë përmendet edhe emri “Vlahi”. Ai përsëritet edhe në vitin 1020 në një letër që i drejtohej Arqipeshkvit të Ohrit, i cili njoftohej për prezencën e vllahve në Bullgari. Pas kësaj kohe emri vllah përdoret më shpesh kryesisht në dokumentet doganore por edhe në sfera të tjera.

Ka shumë mendime se emri “vllah” është me origjinë gjermanike, që do të thotë i huaj. Me këtë term gjermanët quanin fisin fqinj të keltëve dhe ky emer u përdor më gjerësisht kur u romanizua Galia. Më pas u përdor për të gjithë popujt e romanizuar, përfshi edhe këtë pjesë të popullsisë iliro-trake. Për këtë të fundit ndoshta ka ndikuar edhe sjellja e kolonëve galë. Përdorimi i këtij emri në Ballkan u bë për të dalluar këtë popullsi nga jo latinët e Ballkanit si shqiptarët, grekët, bullgarët, serbët etj.<sup>31</sup>

Grekët i quajnë arumunët “kucovllah”, një term përbuzës që do të thotë gjysmëvllah apo gjysmëlatin. Shqiptarët i kanë thirrur vllahët e Shqipërisë vllah, çobanë (që lidhet me profesionin e tyre) por më pak i kanë quajtur edhe “karagunë” apo “sarakaçanë”, llacifacë, sllavët i kanë quajtur “zinzarë”. Vetë vllahët e quajnë veten e tyre “arumunë”, “aromëni”.

Vështirësitë e një studiuesi të vllahve për të riprodhuar të kaluarën e tyre janë të ngjashme me ambientin e papërcaktuar në të cilin vllahët kishin ndërtuar banesat e veta verore. Bëmat e këtij populli të largët dhe të pakapshëm janë të fiksuara në burime të vjetra dhe të panjohura. Ka një hapësirë të pashpjegueshme dhe të palidhshme midis pjesës së humbur latinfolëse të Ballkanit nën valët e pushtuesve barbarë në fund të shek. VI dhe shfaqjes për herë të parë të vllahve në burimet e shkruara në shekujt e mëvonshëm. Kur vllahët shfaqen në shek. XI dhe XII, ne përballemi me probleme kontradiktore rreth çështjeve se ku jetonin ata dhe me çfarë merreshin.

Për historinë e hershme të vllahve nuk mund të jepet një raport i detajuar.

---

<sup>31</sup> Arqile Bërxoli, *Minoritetet në Shqipëri*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë: 2005, f. 113.

Që nga shek. VI të erës sonë, ekzistenca e vllëve në Ballkan mund të nxirret nga lista e fortesave dhe e qyteteve të fortifikuara të dhëna nga Procopius. Midis një numri emrash të vendeve, disa prej të cilave janë italiane si p.sh. Castello Novo, gjenden emra të tjerë si Skeptekasas, Burgualtu, Lupofantana dhe Gemellomuntes të cilat janë pagabueshmërisht vllëve. Këta dëshmojnë se vllahishtja në këtë kohë ishte një gjuhë e veçantë midis gjuhëve romane.<sup>32</sup>

Dyndja e sllavëve nga shek. VI, e më vonë, i shkuli fiset vllëve nga tokat fushore, duke i detyruar të shpërnguleshin e të shtegtonin drejt Jugut në luginat malore të Ballkanit, që kishin kushte më të përshtatshme për blegtori, dhe sidomos në Maqedoni, në zonën e Pindit (arumunët) dhe në Shqipëri (vllëhtë).

Pas shek. VI, ka një periudhë kohe që vllëhtë nuk përmenden. Rreth vitit 976, në faqet e Cedrenus thuhet se, Davidi, vëllai i Samuelit, Carit të Bullgarisë, ishte vrarë midis Kosturit dhe Prespës nga disa vllëhtë nomadë të rëndësishëm. Kjo ishte përmendja e parë e emrit vllah, por pas kësaj ky emër filloi të përmendej në mënyrë frekvente dhe disa rajone u emërtuan me këtë emër. Vllahia e Madhe për disa shekuj ishte emri me të cilin quhej Thesalia dhe Maqedonia e Jugut, ndërsa Vllahia e Vogël përmblihte pjesë të Akarnanisë, Etolisë dhe Epirit.

Në Strategikon të Kekaumenos ka një përshkrim të vllëve në Thesali, përreth Trikkalës dhe Larisës në shek. XI. Mënyra e tyre e jetesës atëherë në shumë drejtime të rëndësishme ishte si ajo e shekullit XIX. Nga prilli deri në shtator tufat e bagëtive dhe familjet e tyre jetonin në male. Moralisht ata përshkruheshin si tradhtarë të pabesë kundrejt gjithë njerëzve dhe pa besim tek zoti, si mashtrues pa zemër dhe si trima vetëm për të kryer poshtërsi. Ky ishte përshkrimi i Kekaumenos. Thesalia ishte atëherë plot vllëhtë.<sup>33</sup>

Njëqind vjet më vonë, kemi një përshkrim tjetër në një revistë të Rabbi Benjamin te Tudela-s, i cili udhëtoi deri në bregdetin lindor të Greqisë në vitin 1160. Ai shkruante: “Sinon Potamo ose Zeitun (Lamia e sotme) ishte një ditë udhëtim më tej. Këtu janë kufijtë e Vllahisë, një vend banorët e të cilit quhen vllëhtë. Ata janë të shpejtë dhe zbresin nga malet e tyre në fushat e Greqisë duke kryer vjedhje dhe duke bërë plaçkë. Askush nuk ka marrë mundimin të bëjë luftë me ta dhe asnjë mbret nuk i

<sup>32</sup> A.J.B. Wace, M.S.Thompson, *The Nomads...*, f. 256-257.

<sup>33</sup> *Po aty*, f.258.

ka nënshtuar ata. Ata nuk e ushtrojnë besimin kristian. Emrat e tyre kanë origjinë hebraike dhe disa thonë se ata kanë qenë hebrenj, komb të cilin ata e thërrasin vëlla. Nëse ata takojnë një izraelit e grabisin, por asnjëherë nuk e vrasin atë, siç bëjnë me grekët.”<sup>34</sup> Sipas këtij përshkrimi rezultoi se kufijtë e Vllahisë ishin në Jug të Thesalisë.

Në shekullin midis dy përshkrimeve të lartpërmendura ka disa referenca nga Anna Komnena, e cila thotë: “Perandori Alexius, në marshimin e tij në Thesali kaloi pranë një kodre, e cila quhej në gjuhën e përbashkët të racave Kissavos dhe më pas zbriti në Exeva, një qytet vllah i vendosur pranë Andronia-s”. Ajo shkruan në lidhje me Enosin se disa nga bullgarët dhe ata që ishin popullsi nomade quheshin bashkarisht vllahë”. Pudilius konsiderohej si një lider i shquar vllah në Thrakë, dhe vllahët përmenden se shërbenin si udhërrëfyes për Comans (kumanet) në malet e Ballkanit.

Aty nga fundi i shek. XII, vllahët papritmas dalin në pah. Në vitin 1186 Perandori Isak rriti taksat dhe mori taksa për tufat e bagëtive. Bullgarët dhe vllahët në veri u rebeluan. Udhëheqësit e kryengritjes ishin Peter dhe Asan, të cilët sipas historianit të asaj kohe, Nicetas ishin të racës vllahë.

John Cantacuzenus (Johan Kantakuzeni) dhe Isaku zhvilluan disa beteja kundër vllahëve dhe bullgarëve, të cilat më së shumti i humbën. Por ndërkohë shpërtheu një luftë civile midis vllahëve dhe bullgarëve.

Pas kësaj mbreti i bullgarëve dhe i vllahëve u bë Johannitus, (Joannice) ose Johanizza siç quhej ai në raste të ndryshme. Ai sundoi nga viti 1197 deri pas pushtimit francez të Konstandinopolit, pra deri në vitin 1207. Ndërkohë Chryses, një vllah që ishte guvernator i Strumicës, u rebelua kundër Bizantit. Pas disfatave që pësoi ushtria bizantine e drejtuar nga Alexius, ky i fundit e njohu Chryses si sundues të Prosakonitit dhe Strumicës, së bashku me territorin përreth. Kështu, në vitin 1199, u krijua në Vardar, një shtet gjysëm i pavarur nën drejtimin e një komandanti vllah dhe me një popullsi të rëndësishme vllahë.

Më tej, Chryses vijoi pushtimet e Prilapus dhe Pelagonias, ndërsa aleati i tij Kamytses avancoi nga Veriu duke hyrë në Thesali. Por rezultati final i këtij aksioni ishte dështimi. Chryses e humbi kështu dhe zotërimin e Strumicës.

---

<sup>34</sup> *Po aty.*

Në këtë kohë, Johannitius kishte hedhur idenë e gjetjes së mbështetjes në Perëndim, tek Roma, së cilës i bëri thirrje për njohjen e tij. Apeli i tij u pranua me kënaqësi nga Papa. Midis Papës dhe mbretit Johannitius u shkëmbyen disa letra në të cilat ky i fundit nënvizonte origjinën romake të vllëve, një pretendim të cilin Papa e pranoi dhe vijoi t'i jepte njohjen zyrtare mbretërisë së Johannitius-it dhe njohjen e privilegjit për të prerë monedha. Këto tratativa zhvilloheshin kur Kryqëzata e Katërt kishte filluar dhe latinët kishin arritur në Konstandinopol. Perandori Alexius u rrëzua nga fronti. Por më tej kryqtarët i kërkuan mbretit vllah të pranonte nënshkrimin e varësinë nga perandori i ri latin i Bizantit. Ai nuk u nënshtrua dhe lufta filloi më e rreptë. Vllehtë dhe Bullgarët të ndihmuar edhe nga Grekët luftuan fort kundër kryqtarëve latinë.

Kryqtarët u thyen keqas në një betejë jashtë Adrianopojës,. Perandori Baldwin u zu rob dhe apelet e Papës Innocent III për lirimin e tij nuk bënë efekt. Baldwini vdiq ose u vra pak muaj më vonë në Bullgari. Pak më vonë Seres ra në duart e vllëve dhe u shkatërrua.

Në vitin 1207, Johannitius u vra nga njëri prej njerëzve të tij. Ai u zëvendësua nga motra e tij Borilas, e cila sundoi deri në vitin 1218 kur ajo u përmbys nga fronti nga njëri prej djemve të Asanit, i cili u njoh si Johannitius Asan ose Johannitius II. Kryeqyteti i tij ishte Tirnova bullgare. Ai, duke përdorur luftën dhe diplomacinë, zgjeroi shumë kufijtë e mbretërisë së tij. Në Jug, ai arriti kufijtë e Thesalisë ose të Vllahisë së Madhe, në Perëndim arriti kufijtë e Ilirisë dhe në Lindje të Seres. Me vdekjen e tij në vitin 1241, mbretëria e tij u shpërbë.

Është e pamundur që të përcaktohet pozita relative e racave bullgare e vllëve në mbretëritë e Asaneve. Ndoshta më e besueshme është që vllehtë kanë qenë në minorancë dhe ka pasur një tendencë të vazhdueshme midis tyre për t'u konvertuar në bullgarë. Theksimi i origjinës vllahe nga sunduesit e kësaj mbretërie, ndoshta është bërë për arsye diplomatike dhe nga dëshira për të fituar mbështetjen nga Roma.

Ndërsa mbretëria vllahe e bullgare po binte, vllehtë papritmas fituan me shpejtësi një rëndësi politike në Veri, në malet e Epirit dhe në Thesali.

Me ndarjen e Perandorisë Bizantine, kur Vllahia e Madhe dhe Selaniku ranë në duart e Bonifacit, Vllahia e Vogël ose Epiri, Etolia e Akarnania kishin mbetur greke dhe popullsitë e tyre të përziera, greke, shqiptare e vllahe u bashkuan në urrejtjen e tyre kundër frankëve. Pas

vdekjes së Bonifacit, mbretëria e Selanikut ra, sunduesit grekë zgjeruan kufijtë në Lindje dhe u krijua një shtet i ri i pavarur me një popullsi kryesisht vllahe. John Ducas u bë mbreti i Vllahisë së Madhe, e cila jetoi deri në vitin 1308. Në vitin 1350 Vllahia e Vogël u pushtua nga Serbët.

Kështu në shek. XIV, historia e vllahve bie dhe krijohet një boshllëk i errët deri pas pushtimit osman, ku nuk ka informacion për këtë popull.<sup>35</sup>

Pamundësia e shumicës së burimeve bizantine për të dhënë informacion për rajonet përtej portave të Konstandinopolit, prirja e tyre për t'i konsideruar të gjithë ata që nuk flisnin greqisht si barbarë dhe ngurrimi i tyre, i inkurajuar nga tendencat arkaike, për të qenë të sakta ndaj llojeve të barbarëve që ato përmendin, nuk na ndihmon. Ne nuk mund të jemi të sigurt, se ata që quheshin vllahë ishin patjetër latinishtfolës, ne nuk mund të jemi të sigurt se latinfolësit nuk mund të fshiheshin edhe nën emrat e bullgarëve, mysianëve ose madje edhe skythianëve dhe, mbi të gjitha, ne mund të mbështetemi pak në ndonjë argument që nga qetësia provon se vllehtë ishin prezent.

Ndërsa në shek. XIII-XV tabloja është krejtësisht e ndryshme. Tani nuk mungojnë referencat për vllehtë, sidomos me themelimin e Perandorisë Asenide, vllaho-bullgare, ku ndeshet edhe përdorimi i Vllahisë si një emër alternativ i Thesalisë dhe shfaqja e Rumanisë në veri të Danubit. Problem real për këtë kohë bëhet dallimi i një lloji të vllahve nga një tjetër. Burimet bizantine flasin për gjeneralë që marshojnë bashkë me vllehtë ose kundër tyre. Në këtë fazë problemi i vllahve është i lidhur në mënyrë të pandashme me problemin e vështirë të origjinës së popullit rumun. Ne shohim “ashtu si Liza në botën e çudirave, se vllehtë mund të jenë çelësi për të hapur derën e problemit rumun, dhe në qoftë se ne do ta hapim këtë derë, ne mund të gjenim këtë çelës të humbur”<sup>36</sup>.

Pushtimi turk paraqet një sërë vështirësish të tjera. Turqit u vendosën në një numër të madh afër dhe në territoret e mëparshme që gjendeshin vllehtë, si Thesalia, Lugina e Vardarit dhe ishin shkaktarë të lëvizjeve të mëdha të popullsive. Historianët dhe udhëtarët turq, ashtu si dhe paraardhësit bizantinë, nuk ishin kureshtarë ndaj racave që ishin tani subjekte të tyre, por ishin më shumë të interesuar për Stambollin. Por fatkeqësisht në këtë fazë të historisë së tyre vllahët dallohen me shumë

<sup>35</sup> *Po aty*, f.260-265

<sup>36</sup> T. J. Winnfrith, *The Vlaches: The history of a Balkan People*, New York: 1987, f.40.

vështirësi nga grekët. Përbuzja greke për këdo që nuk fliste greqisht, ndihmon që ne në disa raste të dallojmë vllahët nga grekët në shekujt XIII e XIV.

Kronikat sllave që mbulojnë periudhat e Mesjetës së vonë dhe të periudhës moderne të hershme e komplikojnë më tej çështjen, pasi ata përdorin termin vllah në kuptimin origjinal “i huaj” që i referohej kujtdo që nuk ishte sllav. Edhe burimet perëndimore duket qartë, se japin një tablo kaq konfuzë për gjithë Ballkanin, saqë referencat e tyre të pakta për vllahët, megjithëse interesante, duhet të trajtohen me kujdes<sup>37</sup>.

Me rënien e Perandorisë Osmane, udhëtarët perëndimore kishin filluar të vizitonin Ballkanin dhe meqë vllahët ishin në zonën që qëndronte në ballë të lëvizjes për pavarësi, ato tashmë dolën nga errësira e plotë në një dritë relative, duke u bërë një element i shënimeve apo referencave në historinë evropiane. Periudha midis viteve 1770 deri më 1918, kur vllahët ishin pjesë në diskutimet ballkanike, dhe kur Ballkani ishte bërë problem i rëndësishëm i Evropës, ishte periudha në të cilën më së shumti mund të gjykohej rreth vllahëve, dhe kur më së shumti është shkruar rreth tyre.

Më vonë konfuzioni u rrit nga lufta dhe politika, të cilat penguan afirmimin e vllahëve dhe gjithashtu edhe studimet rreth tyre. Përballë qytetërimeve të spikatura që i kërcënonin ata, vllahët dukej se po jetonin ende heroikisht në stilin e thjeshtë të poemave të Homerit.

Përprjekjet e qeverive për të manipuluar vllahët në favor të tyre duhet të shihen si ndikuese në punën e historianëve, të frymëzuar nga krenaria kombëtare, për t'i përdorur vllahët si mbështetje për pikëpamjet e tyre shoviniste.

Para vitit 1913, shumë vllahë jetonin në Maqedoni, e cila synohej të aneksohej nga Greqia, Bullgaria e Serbia. Rumania e kishte të vështirë t'i shtrinte kufijtë e saj në Jug deri në Pind, por ishte e prirur t'i përdorte vllahët si kundërpeshë në mbështetje të pretendimeve të tjera të saj.

Për arsye të jetës së tyre nomade dhe të qenit bilingualë, vllahët ishte e vështirë që të futeshin në ndonjë statistikë, por ishte e lehtë të manipuloheshin kur synohej manipulimi i statistikave etnologjike.

Historia e vllahëve dhe gjuha e tyre ka qenë vazhdimisht një dhuatë për historianët shovinistë që ishin të zellshëm të provonin synimet e vendit të tyre ndaj një territori të diskutueshëm. Ky trajtim shovinist ka

<sup>37</sup> *Po aty.*

vazhduar në studimet historike, gjuhësore dhe etnologjike të Maqedonisë deri në ditët e sotme. Kohët e fundit ka pasur disa studime më objektive me karakter shkencor, por në përgjithësi këto studime kanë qenë më shumë gjuhësore e gjeografike se sa historike dhe në përgjithësi studimet për vllehtë janë ende të mbarsura me shovinizëm dhe padije.

Për grekët, vllehtë janë përgjithësisht grekë të cilët flasin një dialekt latin me një përzierje të madhe të fjalëve greke të huazuara. Të preokupuar për të provuar se vllehtë nuk mund të pretendohen nga ndonjë tjetër, ata nënvizojnë vazhdimësinë e popullsisë vllahe në zonat që tani banohen prej tyre. Ideja se ka pasur folës latinë në malet e Pindit qysh nga koha e romakëve, ka qenë shumë tërheqëse për grekët. Por ka pak fakte solide që ta mbështesin këtë. Gjithashtu nuk ka prova të shumta që të tregojnë se si këta folës latinë ishin në të vërtetë grekë. Ushtarët latinë mundet dhe ndoshta janë martuar me banorët lokalë por nëse këto gra flisnin greqisht fëmijët duhej të flisnin greqisht dhe latinishtja do të kishte vdekur.

Çështja e madhe, se sa larg në Veri, shtriheshin grekët në periudhën klasike, dhe se deri ku grekët iu mbijetuan invazioneve sllave, natyrisht që është një çështje e hapur, por studiuesit grekë kanë tendencë t'i injorojnë këto probleme dhe të kapërcejnë në mënyrë qesharake nga armatat që Aemilius Paullus vendosi në kufijtë e një seksioni të Maqedonisë në vitin 167 para erës sonë, tek armatat që luftonin për pavarësinë e Greqisë në shek. XIX, duke arritur në përfundimin se, ato duhet të ishin të njëjtat, duke injoruar vështirësitë e kapërcimit të dy mijëvjeçarëve.

Studiuesit rumunë kanë punuar në një nivel më serioz dhe studimet më të detajuara për vllehtë janë bërë nga ata. Prej studiuesve si T.Capidan dhe P.Papahagi, ne trashëgojmë koleksionet më të mira poetike e folklorike. Këta studiues natyrisht janë shumë të prirur të nënvizojnë lidhjet midis atyre që ata i quajnë Rumunët Dakianë dhe Rumunëve Maqedonë dhe kjo tendencë i jep ngjyrën përmbledhjeve të tyre. Historianët e tillë me profil të stërmadh si I. Iorga, E. Stanescu dhe P.Nasturel, natyrisht kanë nënvizuar prezencën e vllëve në pjesën jugore të Gadishullit Ballkanik dhe gjuhëtarët modernë si E. Petrovici dhe P. Neiescu kanë bërë një punë të mirë në përcaktimin e prezencës së vllëve në Jugosllavi e Shqipëri, megjithëse ata nuk i kanë shtrirë kërkimet e tyre në Greqi.

Megjithëkëtë rumunët po zhvillojnë një luftë në dy fronte. Ndonëse përpiqen me vendosmëri të nënvizojnë se vllehtë janë në të vërtetë rumunë, ata janë të kujdesshëm që të provojnë se rumunët nuk janë vllahë. Me fjalë të tjera, ndërsa ata e vendosin prezencën e latinfolësve në Jug, ata nuk mund ta dobësojnë pretendimin e tyre për një prezencë të vazhdueshme të latinfolësve në veri të Danubit. Kështu që ekziston një tension i rëndësishëm në pretendimet rumune, i cili shihet më mirë në artikujt që trajtojnë Mbretërinë Asenide dhe origjinën e vllahëve të Pindit. Studiuesit rumunë nuk mund të pranojnë tërësisht se, vllehtë që jetojnë tani në Pind kanë qenë autoktonë ose rezultat i një emigrimi jugor në shek. X dhe se Mbretëria Asenide e kishte bazën e saj në jug-lindje të Bullgarisë ose pranë Danubit.

Rumunët, të shqetësuar për të mbajtur Transilvaninë dhe Dobrukhën, pavarësisht nga prezenca e një minoriteti jorumun në të dy rajonet, e kanë parë prezencën e një elementi me karakteristika të vakëta rumune, në Greqi, si një rast shumë të favorshëm për kundërbalancim<sup>38</sup>. Autorë dhe politikanë rumunë vazhdimisht kanë mbështetur tezën se, arumunët e Ballkanit, kishin origjinë rumune. Një deputet i shumicës në Dhomën e Deputetëve të Rumanisë, I. Gradishteau deklaroi në parlamentin rumun në vitin 1924 se “rumunët e Gadishullit Ballkanik, me prejardhje nga Dakia, nga zona e Karapacit, zbritën në malet e Pindit në Shqipëri dhe në Greqi qysh në mbarim të shek. IX dhe në fillim të shek. X<sup>39</sup>.”

Bullgarët nuk kanë qenë asnjëherë të interesuar shumë për vllehtë. Ata kanë pasur shumë argumente për pretendimet e tyre për të qenë sundues të pjesës sllavofone të Maqedonisë, të cilat u janë mohuar nga Traktati i Shën Stefanit dhe më pas. Megjithatë është në kundërshtim me interesin e bullgarëve fakti që perandoria e dytë bullgare e Asenidëve është pohuar nga një sërë burimesh se ka qenë një perandori vllahe dhe nuk është e habitshme që historianët bullgarë si V. Zlatarski dhe P. Mutafçiev, në kundërshtim me rumunët, përpiqen ta minimizojnë elementin vllah në këtë perandori<sup>40</sup>.

Jo vetëm bullgarët në Jug, por edhe hungarezët në Veri, në studimet e tyre, cenojnë interesat rumune. Rumunët dëshirojnë të tregojnë se ata

<sup>38</sup> *Po aty*, f.51-52.

<sup>39</sup> Interpelancë e I. Gradishteau, deputet i mazhorancës në Dhomën e Deputeteve të Rumanisë, botuar në: *Shqipëria e Re*, 18 maj 1924.

<sup>40</sup> Robert Wolff, “The Second Bulgarian Empire”, në: *Speculum*, nr. 24 (1949), f.167-206.

kanë jetuar në veri të Danubit qysh nga koha e Trajanit. Por, kjo është në kundërshtim me pretendimet e hungarezëve e madje edhe të gjermanëve, të cilët nënvizojnë se, rumunët arritën në Transilvani pas ngulimeve hungareze dhe gjermane. Ndoshta, nuk është rastësi që një transilvanian R. Rösler, popullor midis grekëve, por i padëshirueshëm për rumunët, në *Römanische Studien* (Leipzig 1879) është bërë eksponenti kryesor i teorisë se, si vllëhtë dhe rumunët e kanë origjinën në jug të Ballkanit dhe se ka pasur një emigrim në veri, të rumunëve drejt Rumanisë gjatë Mesjetës, duke bërë xhepa të izoluar latinfolësish në vendin e origjinës. Vepra e studiuesit hungarez M. Gyóni, që përcakton prezencën e vllëve në Ballkanin Jugor, ka të njëjtin orientim.

Pas Greqisë, Jugosllavia ka numrin më të madh të vllëve, por jugosllavët e kanë zvogëluar prezencën e vllëve. D. Popoviç, autori i librit të kritikueshëm mbi vllëhtë, "O Cincarima" (Beograd 1935), i cili përmban një informacion të pakët për periudhën mesjetare, nënvizon lidhjet e tyre me grekët dhe përpiqet ta shohë prezencën e vllëve në Jugosllavi si evidencë të kolonizimit të vonë nga Jugu dhe jo si mbijetues nga kohët e vjetra. Kjo për arsye se Popoviç ishte serb, ndërsa shkrimtarët nacionalistë kroatë si F. Eteroviç, C. Spolatin dhe S. Gazi, duan të na bëjnë të besojmë se serbët më së shumti janë vllëhtë që kanë humbur gjuhën e tyre vllahe.

Nga shumë autorë madje edhe italianë, arumunët përshkruhen si një popull nomad. Amadori shkruante se "kucovllahët në shumicën e tyre përbëjnë një popull nomad të malësive. Qendra territoriale e tyre shtrihet në Pind. Në malet e Epirit e në Manastir jetojnë grupe të shpërndara të vogla barinjsh. Numri i tyre ka qenë gjithmonë i vështirë të përcaktohet nga autorët e ndryshëm."<sup>41</sup>

Origjinën latine të arumunëve e ka vënë në dukje edhe Baldacci. Ai shkruante se rumunët e trekëndëshit Vlorë-Ardenicë--Berat janë të gjithë pjesëtarë të grupit Farsaliota, i cili ka afinitet të madh etnik e antropologjik me disa italianë tipik të Italisë Jugore ku Çezari formoi Legjionin e V<sup>te</sup> të tij. Këta romanë u lanë prej Çezarit, siç supozohet, për të mbikqyrur jetën në Apoloni, Durrës e Maqedoninë e Brendshme, provinca që kishin marrëdhënie të rregullta me Romën<sup>42</sup>.

<sup>41</sup> G. Amadori, *Virgilj, La Questione Rumeliota...*, f.311.

<sup>42</sup> Antonio Baldacci, *I Romeni dell'Albania*, Roma: 1914, f.10.

Baldacci e pranonte se këto popullsi romane, me gjak e me shpirt, që flisnin dialekte shumë të afërta midis tyre me disa përzierje fjalësh shqipe e greke, ishin shumë larg ndërtimit të një uniteti kombëtar. Pikërisht për këtë arsye koncepti i bashkimit shqiptaro-rumun është më tepër një akt për t'i shpëtuar asgjësimit të tyre dhe rreziqeve të asimilimit të jashtëm<sup>43</sup>. Prandaj arumunët deklarorin se nuk pranorin program tjetër përveç pavarësisë shqiptare dhe për këtë qëllim ata nuk donin të vinin në dyshim miqësinë e përzemërt me popullin shqiptar. Ata shpresonin se ashtu sikurse ishin lidhjet e Itaisë me Shqipërinë ashtu do të ndërtoheshin marrëdhëniet miqësore midis arumunëve dhe shqiptarëve. Arumunët formojnë ishuj etnikë në masën shqiptare. Është e drejtë e logjike që ata të kërkojnë të përfshihen në atë unitet që përfaqëson popullin shqiptar dhe janë të afërt me të sepse atdheu i largët nuk mund t'i mbështesë shumë<sup>44</sup>.

Njohja e Maqedonisë pas vitit 1945 si një entitet i veçantë me gjuhën e vet i nxiti disa historianë që të përpiqeshin të gjenin origjinën e maqedonasve në periudhat e hershme. Natyrisht ky komb duhej të ishte sllav, me gjithë zemërimin e grekëve, por ai nuk mund të ishte bullgar dhe vllahët e mjerë mbetën jashtë vëmendjes. Sigurisht ka shumë dyshime mbi origjinën racore të Samuelit, i cili ka qenë sundimtari i fundit dhe njëri nga më të mëdhenjtë e Perandorisë Bullgare. Meqë qendra e Perandorisë së tij ishte rreth liqeneve të Ohrit dhe Prespës, patriotët maqedonas kanë qenë shumë të preokupuar për ta paraqitur atë si maqedon. Vepra e J. Trifunovskit, me një numër artikujsh rreth vllahve të Maqedonisë, është e pavlefshme lidhur me përcaktimin e vendosjes aktuale të vllahve. Ai deklarorin kategorikisht se, vllahët janë emigrantë të vonshëm të ardhur nga Shqipëria, megjithëse pranorin se ndoshta ka pasur vllahë në Maqedoni dhe në krahina të tjera të Jugosllavisë përpara invazionit vllah të shek. XIX dhe kjo gjë duket se tashmë, pranohet si nga kroatët ashtu dhe nga serbët<sup>45</sup>.

Shqipëria, e cila ka një gjuhë, mbijetesa e së cilës është e ngjashme me atë të vllahve dhe populli i saj në historinë mesjetare është ngatërruar shpesh me vllahët, nuk ka pasur ndonjë studim rreth çështjes vllahe. Problemi i arumunëve është nga problemet më pak të njohura në Shqipëri

<sup>43</sup> *Po aty*, f.12.

<sup>44</sup> *Po aty*.

<sup>45</sup> T.J.Winnfrith, *The Vlaches...*, f. 46.

dhe nga më të diskutueshmet në literaturën politike e historiografike të huaj, e cila në disa pjesë të saj reflekton interesat politike e gjeopolitike të shteteve e të palëve të interesuara.

Por në Fjalorin Enciklopedik Shqiptar, thuhet se, vllehtë janë një popullsi me prejardhje nga fise të vjetra ballkanike të romanizuara, e cila sot është e shpërndarë në një varg visesh të Gadishullit Ballkanik, Qendror e Jugor duke përfshirë edhe disa krahina të Shqipërisë, kryesisht të Jugut. Gjuha e saj është një degë e rumanishtes së lashtë.

Në Ballkan vllehtë përbëjnë një popullsi me tipare dalluese etnike, me gjithë procesin e asimilimit në mjediset ku jetojnë dhe me kalimin në një mënyrë jetese më të përparuar. Të folmet e tyre kanë sot interferenca me gjuhët sllave, shqipe e greke.

Duke qenë kryesisht barinj shtegtarë (sarakaçanë), vllehtë ruajtën mirë deri në fund të shek. XIX, zakonet, veshjet e tyre dhe një organizim bashkësish të tipit patronamik të drejtuar nga krerët e tyre (çelnicët, gllavarët, koxhabashët etj.), të cilët ishin zakonisht pronarët më të mëdhenj të tufave. Vllehtë ishin të njohur në të gjithë Ballkanin edhe si pronarë mushkash e qiraxhinj.

Në gjysmën e dytë të shek. XIX, në trevat shqiptare, një pjesë e vllëve ishin ngulitur në fshatra, një pjesë vazhdoi jetën e barinjve shtegtarë, kurse një pjesë tjetër u vendos në qytete, sidomos në Voskopojë dhe pastaj në Tiranë, Durrës, Elbasan, Berat, Korçë. Në këto qytete u morën kryesisht me zejтари e tregti, duke humbur shkallë-shkallë kompaktësinë etnografike dhe pjesërisht duke u asimiluar. Pas Luftës së Dytë Botërore vllehtë shtegtues, që dikur shkonin nga Opari e Vithkuqi deri në Sarandë, duke përparuar bashkë me shndërrimet e thella ekonomike-shoqërore të gjithë vendit, janë vendosur në rrethet e Jugut<sup>46</sup>.

Kombet e tjera që kanë pasur më pak interes për vllehtë dhe më shumë interes në mbajtjen e një qëndrimi objektiv kanë pasur pak studime rreth tyre. Udhëtarët turq Evliya Çelebi dhe Kâtip Çelebi kanë dhënë informacion të dobishëm për prezencën e vllëve deri në Liqenin Dorian në shek. XVII, duke kundërshtuar kështu teoritë e atyre që pohojnë se shumica e vllëve në lindje të Pindit janë rezultat i emigrimit nga Shqipëria. Gjithashtu ka shumë dokumente osmane që ndriçojnë këtë çështje.

---

<sup>46</sup> *Fjalori Enciklopedik Shqiptar*, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Tiranë: 1985, f. 1172.

Udhëtarë të tjerë perëndimorë si Pouqueville dhe Leake, janë një minierë informacioni për vllehtë. Veprat e G. Weigand-it ende janë të vlefshme megjithëse ai ndoshta nuk i ka dhënë rëndësinë e duhur vllëve të Greqisë dhe është akuzuar se ka pasur një frymëzim pro-sllav. Ai nuk është historian, por duke u përqendruar në gjuhën vllahe, në traditat dhe në filologjinë e tyre, ai është atakuar nga studiuesit rumunë. Paraqitja panoramike që ai u ka bërë kombeve të Ballkanit dhe përpjekjet e palodhura të tij si udhëtar duhet të ngjallin admirimin tonë, megjithëse teoritë e tij se trakët ishin paraardhës, të shqiptarëve modernë dhe se vllehtë ishin pasardhës të trakëve të latinizuar, nuk bazohen në argumente solide.

Vepra e hershme e C. Bratter-it, *Die koutzovlachische Frage* (Hamburg, 1907) është një antidod i dobishëm kundër pretendimeve greke. Më vonë M. D. Peyfuss në *Die Aromunische Frage* (Vienna 1974) dhe disa artikuj të mëvonshëm, japin një informacion shumë të vlefshëm për vllehtë në shek. XIX.

Wace dhe Thompson kanë shkruar studimin e vetëm serioz në anglisht. Disa autorë i konsiderojnë vllehtë si një popull autokton i Ballkanit. Wesley M. Gewehr shkruan se, nga të gjashtë popujt e Gadishullit Ballkanik, tre janë vendosur në këtë Gadishull në kohët më të vjetra dhe mund të konsiderohen autoktonë. Këta janë shqiptarët, vllehtë dhe grekët. Tre të tjerët, serbët, bullgarët e turqit otomanë kanë ardhur këtu si pushtues.

Vllehtë konsiderohen si të afërm prej rumunëve modernë. Ka shumë të ngjarë që vllehtë dhe rumunët të jenë pasardhës të fiseve të vjetra trake, të cilët pushtuan pjesën lindore të gadishullit para pushtimit romak dhe që më vonë u latinizuan nën sundimin romak<sup>47</sup>.

Pastaj erdhën pushtimet e mëdha sllave. Elementi latin u zhduk, u asimilua ose u dëbua në rajone të izoluar në të cilat mbeti mënjane influencave të huaja, për shumë shekuj. Kur këta latinë filluan procesin e ndërtimit të shtetit, shumica e tyre ishin vendosur në rajonin në veri të Danubit, i cili përkon me Rumaninë e Transilvaninë moderne. Deri më sot fshatrat vllëve mund të gjenden të shpërndara në malësitë e izoluar të Gadishullit Ballkanik, veçanërisht në kodrat e luginat e Pindit midis Thesalisë dhe Shqipërisë. Me ndarjen e Maqedonisë midis shteteve fqinje

<sup>47</sup> Wesley M. Gewehr, *The Rise of Nationalism in the Balkans, 1800-1930*, New York: 1931, f.5.

ballkanike dhe me caktimin e kufijve nacionalë vllehtë filluan të asimilohen me shpejtësi<sup>48</sup>.

Edith Durham duke përkrahur autoktoninë e vllëve shkruante se: “Sllavët, shkelës qenë paganë, kurse shumica e vendësve ishin të krishterë”. Ajo i referohet, Presbyter Diokleas, i cili shkruan se “Të krishterët, duke e parë veten në mjerim dhe të persekutuar, u tërhoqën në male dhe ndërtuan kështjella e fortesa për të shpëtuar nga duart e sllavit, gjersa t’u vinte perëndia në ndihmë e t’i çlironte. Kjo është ndoshta origjina e banimit të vllëve, nëpër maja të brigjeve dhe e shqiptarëve në male”<sup>49</sup>.

Pavarësisht nga interesi i francezëve mbi Bizantin dhe Evropën Juglindore, dhe nga fakti se, shumë studiues të vllahëve kanë shkruar në frëngjisht, ka pak libra e artikuj për vllehtë, të shkruar nga francezët, megjithëse Pouqueville natyrisht ka qenë një pionier në studimet ballkanike. M. Recatas, ka shkruar studimin *L’Etat Actuel du Bilinguisme chez les Macédo - roumains du Pinde* (Paris 1934) i cili është interesant, përderisa Recatas ishte një grek nga Anilioni me simpati për rumunët. Studiuesi danez C. Hoeg, ka shkruar një vepër monumentale, *Les Saracatsans* (Paris dhe Copenhagen, 1925-1926). Por, gjithë ajo që ai thotë për këta nomadë greqishtfolës shpesh ngatërrohet me vllehtë, gjë që na bën të kujdesshëm për të marrë me rezerva vlerën e vërejtjeve që ai bën për vllehtë, kur ne nuk jemi të sigurt nëse fjala vllah është përdorur si një term i përgjithshëm për nomadët ose barinjët, si një term etnik ose si një fjalë e abuzuar.

Edhe historiani i njohur, Georges Castellan pohon se, rumunët e sotëm u referohen të parëve të tyre, dakëve që janë element i një blloku trako-dako-indoevropian që mori tipare të përcaktuara në fund të mijëvjeçarit të dytë para Krishtit. Të romanizuar nga një pushtim që zgjati një shekull e gjysëm, nga Trajani te Aureliani (106-271) para Krishtit, ata ruajtën një gjuhë të prejardhur nga latinishtja dhe kanë pasur ndikime të mëvonshme nga gotët dhe sidomos nga sllavët. Ata kanë afërsi me popullsi të shpërndara gjatë gjithë Gadishullit, vllahët, të cilët e cilësojnë veten si arumunë dhe gjenden me emra të ndryshëm: cincarë të Pindit dhe të Greqisë së Veriut, vllah të Serbisë Lindore dhe të Bosnjës;

<sup>48</sup> *Po aty.*

<sup>49</sup> Edith Durham, *Njëzet vitet e trazirave të mëdha, Shqipëria në vorbullën e ngatërresave ballkanike*, Tiranë: “Çabej”, 2001, f. 149-150.

morlakë të bregdetit dalmat dhe të Istrias. Ata janë trakë, gjithashtu të romanizuar gjatë pesë shekujsh dhe që nuk kanë pasur kurrë një shtet të tyre. Lidhja e tyre e vetme është arumunçja, një gjuhë e familjes latine, që kufizohet në të folmet e barinjve<sup>50</sup>.

Duke iu referuar Perandorisë Bizantine ai pohon se, në rrafshin kulturor ajo u helenizua dhe se disa historianë modernë grekë i vendosin midis shek. XVIII dhe IX, fillimet e neohelenizmit, domethënë përdorimin e greqishtes së re të shkëputur nga gjuha e Atikës dhe e caktojnë gjenezën e letërsisë neohelenike rreth vitit 1000. Në fakt greqishtja ishte gjuha e shtetit dhe e kishës dhe gjithçka shkruhej në këtë gjuhë. Vetëm vllhtë, barinj shtegtues-të shumtë në malësitë - flisnin dialekte që vinin nga latinishtja<sup>51</sup>. Por gjithashtu Castellan vë në dukje se arumunët e Epirit e të Maqedonisë ose cincarët e Pindit që ishin blegtorë shtegtarë, kishin gjuhë dhe zakone me prejardhje të ndryshme, por që kishin pësuar gjatë shekujve një ndikim helenik, ku më shumë e ku më pak të fortë<sup>52</sup>.

Arumunët vetë kanë pretenduar se, jetojnë prej shekujsh të shpërndarë në të gjithë Gadishullin e Ballkanit dhe se, ata kanë formuar komunitete të forta pothuajse në të gjitha qytetet e fshatrat e Evropës Juglindore por, kryesisht në Maqedoni, në Epir, në Pind dhe në Thesali ku kanë masa kompakte e homogjene<sup>53</sup>.

Në një memorandum që i paraqitën Konferencës së Paqes në mars të vitit 1919<sup>54</sup>, një Komitet arumun jepte dy alternativa për origjinën e tyre. Ata e konsideronin veten pasardhës, të paktën pjesërisht, të legjioneve të Pompeit dhe të kolonëve romakë, të cilët emigruan në këto rajone dy shekuj para Krishtit, pas pushtimit të Ilirisë dhe Maqedonisë me iniciativën e Anicius, Pretorit dhe të Paulus Emilius. Ose, çfarë ishte më e mundshme, ata ishin pasardhës të kolonive Dako-Romake, të cilët u tërhoqën nga Dakia Trajane nga Perandori Aurelius në Moesia dhe që u shtynë mbrapa disa shekuj më vonë përtej Maleve Ballkan nga invazioni i bullgarëve, i sllavëve dhe i gotëve. Në memorandumin e lartpërmendur

<sup>50</sup> Georges Castellan, *Histori e Ballkanit, shekulli XIV-XX*, Tiranë: "Çabej", 1996, f.22.

<sup>51</sup> *Po aty*, f.38.

<sup>52</sup> *Po aty*, f.277.

<sup>53</sup> *Po aty*.

<sup>54</sup> A Memorandum of the Macedonian-Roumanians to the Peace Conference, *The Adriatic Review*, mars 1919.

pranohej dhe theksohej identiteti i përbashkët absolut kombëtar i kësaj popullsie me rumunët e Danubit ose dako-rumunët nga pikëpamja etnografike, filologjike dhe nga gjuha. Më tej, vihej në dukje se, përpara pushtimit osman ky element kishte qenë aq i rëndësishëm saqë kishte arritur të formonte komuna të veçanta në malet e Pindit dhe në Thesali me emrat Vllahia e Madhe dhe Vllahia e Vogël, e cila nuk duhet ngatërruar me Vllahinë në veri të Danubit. Këto komuna, të cilat janë përmendur nga kronikat bizantine ekzistonin deri në kohën e arritjes së turqve, të cilët u dhanë arumunëve, në shkëmbim të bindjes së tyre, privilegje të rëndësishme të cilat përfshinin një autonomi në një shkallë të lartë komunale, administrative, gjyqësore dhe fetare. Këto privilegje u ruajtën për një kohë të gjatë dhe mbetën pjesë të tyre deri në periudhën midis Dy Luftërave Botërore. Falë këtyre privilegjeve dhe cilësive të larta të saj popullsia arumune e Turqisë ishte në gjendje të zhvillohej dhe të arrinte në një nivel prosperiteti në rritje<sup>55</sup>.

Gjendja jo e kënaqshme e studimeve për vllhtë e bën të domosdoshëm studimin e mëtejshëm të tyre, por duhet ditur se, një studim i tillë është jashtëzakonisht i vështirë.

### *S u m m a r y*

#### HISTORICAL EVIDENCE ON THE ORIGINS AND THE SETTLEMENTS OF THE VLACHS

The Vlach population and their settlement in the Balkans and in the actual political Albania has often been the object of numerous studies. even in our days, the most reliable sources remain the data given by Gustav Weigand and the last census conducted by the Ottomans.

An even more complicated issue is that of the origins, forming and expansion of the aroumanian ethnic and cultural minority. There are several opinions, as far as the origins of the Vlachs are concerned. These opinions can be divided in several groups. The first group of historians has brought arguments on the thesis that the Aroumans are descendants of the Roman settlers, who were installed in the Balkans after the Roman invasion.

Another group of researchers affirm that the Aroumans are descendants of the Rumanians or the Romans of the Iberian Peninsula, sharing the same

---

<sup>55</sup> A. J. B. Wace, M.S. Thompson, *The Nomads ...*, f. 273.

thraco-illyrian origins and having spread from the Carpathians to the Southern Balkans. This thesis is mostly sustained by Rumanian researchers.

Greek researchers have tried to prove that the Aroumans are Greeks that have become Latins, while another group supports the opinion that the Aroumans have come from the North, from the regions of Danube and Sava.

This article presents the historic evolution of the Vlachs, from antiquity to the 20th century and especially their presence in the Albanian territory.

The relations between the Albanians and the Vlachs, being a positive example in the Balkans, are presented in this article based on numerous historical sources.